



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 422/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Nehat Idrizi, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidates për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës-Synavere Rysha nga subjektit politik Lidhja Demokratike Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e kandidates për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës – Synavere Rysha nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidatja për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Synavere Rysha me nr. 33 të subjektit politik LDK në Ferizaj, me të cilën pretendon se më datë 08.06.2014, në QV 2509D/03R, në vendvotimin ku ka votuar ajo dhe familja e saj, nuk ju kanë evidentuar 114 vota. Parashtruesja e ankesës thekson se këtë parregullsi e ka pranuar edhe komisionari i këtij VV, Nazif Mjaku.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmitë ka bashkangjitur deklaratën e komisionarit dhe Formularin e Rezultateve të Kandidatit (FRK) për vendvotimin 2509D/03R.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “*Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme*”

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidatja për deputete – Synavere Rysha të subjektit politik LDK në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të materialit zgjedhor në QNR, për të cilat kandidati në fjalë pretendon se në vendvotimin me nr.2509D/03R, ka pasur 114 vota të cilat sipas parashtruesit të ankesës nuk janë shënuar në FRK.

PZAP-i ka konstatuar nga FRK-ja origjinale në QNR se janë të shënuara 114 vota lidhur me VV 2509D/03R e jo ashtu siç pretendohet në ankesë që nuk është shënuar asnjë votë në FRK. Prandaj për këtë arsye edhe nuk është hapur fare kutia e votimit për rastin në fjalë sepse votat e kandidatës të lartpërmendur kanë qenë të shënuar në FRK dhe të njëjta janë përfshirë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të publikuar nga KQZ-ja.

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 422/2014 më datën 30.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*